

AKT THEMELIMI

SHOQËRISE ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR
"KULLA - A" SH.P.K.



Sot me datën 26 Nëntor 2005, ne Sarande , me vullnetin tim te lire,
une i nenshkruari :

ANDON KULLA, i biri I Mustafait, i datelindjes 26 Nëntor 1971, lindur
ne Sarande dhe banues ne Delvine, Lagjia " Sinan Ballaci",

ne baze te Ligjit 7638, date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare"

Neni 1

Vendosa te krijoj Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin
" KULLA - A " SH.P.K.

Neni 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete : Tregetim te materialeve
ndertimit, prodhime hekuri, i vajrave lubrifikante, makina , automjete dhe pjese
kembimi, lendeve te para, bojera, pajisje elektro-shtepiake, artikuj elektrike dhe
hidraulike, hidrosanitare, pllaka majolike, alumine dhe aksesore, mallra dhe artikuj
industriale, veshmbathje, import- eksport i tyre, trasport i mallrave dhe artikujve per
llogari te Shoqerise dhe te treteve etj.

Neni 3

Ortak i vetem i Shoqerise eshte Zoti Andon Kulla.

Neni 4

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte ne vleren 100 000 (njeqind mije) .
Kontributi eshte teresisht I Ortakut te Vetem .

Neni 5

Qendra e shoqerise : Qendra e Shoqerise eshte ne Delvine, Lagjia " Sinan
Ballaci".

Neni 6

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte 20 vjet.

Neni 7

Administratori i Shoqerise eshte Ortaku i Vetem , Andon Kulla.

Neni 8

Vendimet qe lidhen me Aktivitetet e Shoqerise merren nga Ortaku i Vetem.

Neni 9

Fitimi qe rezulton nga veprimtaria e Shoqerise , zoterohet ekskluzivisht nga Ortaku i Vetem i saj, sipas kontributit ne masen 100 %.

Neni 10

Shoqeria ka te drejte te krijojë dege dhe filiale te saj ne Republiken e Shqiperise si dhe jashte saj.

Neni 11

Pjetet e Kapitalit jane lirisht te trasferushme ne rruge trashegimie, midis bashkeshorteve dhe personave te trete.

Neni 12

Personaliteti Juridik i Shoqerise fitohet me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Aktiviteti i saj do te filloje pas kryerjes e procedurave ligjore prane Organeve tatimore.

Une Themeluesi i Shoqerise, ne aktivitetin tim ne kete Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar do ti permbahem Statutit te hartuar per kete qellim dhe do te respektoj si dispozitat ligjore ne fuqi ashtu edhe ato qe do te dalin me vone per veprimtarine private te shoqerive prodhuese e tregtare.

Ky akt themelimi u redaktua ne kater kopje, nje kopje dorezohet ne Gjykatën se Rrethit Gjyqesor Tirane , nje kopje tjeter lihet ne Zyren Noteriale, kopja e trete dorezohet ne Degen e Tatimeve dhe kopja e katert do te mbahet nga une Themeluesi i kesaj Shoqerie se bashku me aktet e tjera.

Akti i Themelimit nenshkruhet me vullnetin e lire te Ortakut te vetem , i cili garanton respektimin e permbajtjes se neneve te tij.

ORTAKU I VETEM

Andon Kulla
lyfi

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " KULLA - A " SH.P.K.



Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", une i nenshkruari , **ANDON KULLA**, i biri i Mustafait, i datelindjes 26 Nentor 1971, lindur ne Sarande dhe banues ne Delvine, Lagjia " Sinan Ballaci", si Themelues i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " KULLA - A" SH.P.K., sot me daten 26 Nentor 2005, duke pasur edhe zotesine e plote juridike per te vepruar shpall persa vijon :

FORMIMI NENI I

Formohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " KULLA - A " SH.P.K., me Themelues , Ortakun e vetem Andon Kulla.

QENDRA E SHOQERISE NENI 2

Qendra e shoqerise do te jete ne Delvine, Lagjia " Sinan Ballaci " .
Por me kalimin e kohes selia mund te ndryshoje si brenda dhe jashte rrethit me pelqimin e ortakut te vetem .

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE NENI 3

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj 20 vjet , te njepasnjeshme, por edhe mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cdo shkak nga ortakun i vetem.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise : Tregetim te materialeve ndertimit, prodhime hekuri, i vajrave lubrifikante, makina , automjete dhe pjese kembimi, lendeve te para, bojera, pajisje elektro-shtepiake, artikuj elektrike dhe hidraulike, hidrosanitare, pllaka majolike, alumine dhe aksesore, mallra dhe artikuj industriale, veshmbathje, import- eksport i tyre, trasport i mallrave dhe artikujve per llogari te Shoqerise dhe te treteve etj.

KAPITALI I SHOQERISE NENI 5

Kapitali i shoqerise si fillim do te jete 100.000 Leke, kontribut i vete themeluesit te shoqerise.

Kapitali i kesaj shoqerie me pergjegjesi te kufizuar do te shtohet ose do te pakesohet me kalimin e kohes sipas vendimeve qe do te marri pronari i saj.

NENI 6

Kapitali themeltar i ortakut te vetem eshte lirisht i transferueshem edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie.

Gjithashtu jane lirisht te tranferueshme ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe parardhesve.

Me vullnetin e ortakut kapitali themeltar mund tu transferohet edhe personave te trete.

Ne rast vdekjeje te ortakut te vetem te shoqerise trashegimtare e tij mund te vendosin per likuidimin e shumes se kapitalit themeltar ose per vazhdimin e veprimtarise duke respektuar rregullat e nenin 46 te ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

ASAMBLEA

NENI 7

Ortakut i vetem ushtron gjithe kompetencat qe ligji nr.7638 date 19.11.1992 i ka dhene Asambleses se ortakëve.

Vendimet e ortakut te vetem jane te detyrueshme per administratorin dhe personelin e shoqerise, kur keto jane marre konform ligjit dhe statutit.

NENI 8

Ortakut i vetem ka te drejte :

- Te emeruje dhe te shkarkoje administratorin.
- Te informohet ne cdo kohe per veprimtarine e shoqerise dhe njihet me llogarine dhe dokumentacionin e saj
- Te vendose per kryerjen e kontroll revizionit financiar te shoqerise me ekspert te vendosur prej tij.
- Te jape aprovim financiar per cdo veprim financiar qe mund te kryhet nga administratori ne vleren mbi 500.000 Leke
- Te drejta te tjera qe parashikohen nga ligji "Per Shoqerite Tregtare"

ADMINISTRIMI

NENI 9

Shoqeria do te administrohet nga ortakut i vetem Andon Kulla. Me kalimin e kohes mund te caktohet nje administrator tjetër me pelqimin e ortakut te vetem me nje afat kohe deri ne dy vjet , por me te drejte rizgjedhjeje.

NENI 10

Administratori ka te drejte :

- Te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha marredheniet e saj juridike dhe administrative brenda kompetencave te tij.
- Te kryeje cdo veprim qe e gjykon te arsyeshem dhe konform ligjit
- Te jape urdhëra dhe udhëzime personelit te shoqerise dhe te vendose saksione

ndaj atyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe kontratat e punes.

- Te angazhoje shoqerine ne marredhenie me te tretet nepermjet veprimeve qe jane ne perputhje me objektin dhe strategjine e shoqerise.

- Te pranoje dhe te largoje nga puna brenda shoqerise punemarres ne perputhje me dispozitat ne fuqi, brenda nevojave dhe organikes se percaktuar.

NENI 11

Administratori ka per detyre

- Te punoje e te organizoje ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomike – financiare

- Te zbatoje vendimet e marra nga ortakut i vetem dhe urdhrat e tij te dhena brenda kompetencave te percaktuara nga statuti dhe legjislacioni ne fuqi.

- Te paraqese ne menyre te rregullt raportin e administrimit , inventarin e bilancin dhe llogarite vjetore ortakut te vetem brenda nje afati prej gjashte muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

- Te pergjigjet ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve per shkeljet ligjore , per shkeljet e statutit te shoqerise si dhe per faje te kryera gjate administrimit.

- Te drejta dhe detyrime te tjera te percaktuara nga ligji per shoqerite tregtare.

NENI 12

Per perfaqesimin e shoqerise perpara organeve administrative, gjyqesore ose te treteve duhet firma e administratorit.

NENI 13

Ne rast pengesash si semundje, aksidente, udhetime te administratorit e tjera ortakut i vetem ka te drejten e zevendesimit te perkohshem te tij.

NENI 14

Vula e shoqerise ka forme te rrumbullaket ne te cilen eshte shkruar :
REPUBLIKA E SHQIPERISE, SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" KULLA – A " SH.P.K.

NENI 15

Shoqeria vepron ne regjim te punes private dhe merr persiper te drejta dhe detyrime. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit te saj te fituar.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 16

Veprimet mbylleen me 31 Dhjetor te cdo viti, pervec urdhrave te vecanta qe jep pronari per kete qellim. Administratori nxjerr bilancin me te ardhurat, fitimet, humbjet te formuluar konform ligjit.

NENI 17

Eshte kompetence e ortakut te vetem te vendose per krijimin e fondeve nga te ardhurat neto si dhe perdorimin e tyre.




SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 18

Duke qene se ne cdo kohe dhe per motive te ndryshme shoqeria mund te ndodhet perballe shperberjes ortakut i vetem mund te vendose per menyren e likuidimit te saj ne baze te ligjeve ne fuqi. Ai vendos per likuidimin e nje ose me shume likuidatoreve duke u percaktuar edhe detyrat.

NENI 19

Shoqeria private ka numrin e llogarise rrjedhese te regjistruar ne Banken e Shtetit Shqiptar ne Sarande.



DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 20

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut vlejne dispozitat e ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari

NENI 21

Ky STATUT u redaktua ne kater kopje, nje kopje dorezohet ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane , nje kopje tjeter lihet ne Zyren Noteriale, kopja e trete dorezohet ne Degen e Tatimeve dhe kopja e katert do te mbahet nga une Themeluesi i kesaj Shoqerie se bashku me aktet e tjera.

Statuti i miratuar nga ortakut i vetem nenshkruhet rregullisht prej tij.

ORTAKU I VETEM

Andor Kuller



Sarande, me 13.01.2007

J. A. Dajpa
16.01.2007
18 GEN. 2007
[Signature]

KERKUESI : ANDON KULLA, i biri I Mustafait, i datelindjes 26 Nentor 1971, lindur ne Sarande dhe banues ne Delvine, Lagjia " Sinan Ballaci", me zotesi juridike per te vepruar.

Objekti : Kerkoj depozitim in ne Regjistrin Tregetar te Vendimit Nr. 1, date 13.01.2007 te Ortakut te vetem te Shoqerise " KULLA-A " sh.p.k..

Baza ligjore : Ligji 7667, date 28.01.1993 " Per Regjistrin tregetar" dhe Ligji 7638, date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare".

Perpara Gjykates se Rrethit Gjyqesor,

TIRANE

Ja depozitimi i kullas
Vendim i shitatut vetem
13.1.2007

Me Vendimin Nr. 34478 , date 01.12.2005, te Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane eshte regjistruar si Person Juridik Shoqeria Tregetare " Kulla -A " Sh. P. K., me Seli ne Delvine, me Ortak te vetem dhe Administrator Z. Andon Kulla, me objekt te veprimtarise se saj : Tregetim te materialeve ndertimit, prodhime hekuri, i vajrave lubrifikante, makina automjete dhe pjese kembimi, lendeve te para, bojera, pajisje elektroshtepiake, artikuj elektrike dhe hidraulike, hidrosanitare, pllaka majolike, alumine dhe aksesore, mallra dhe artikuj industriale, veshmbathje, importeksport i tyre, trasport i mallrave dhe artikujve per llogari te Shoqerise dhe te treteve etj.

Me Vendimin Nr. 1, date 13.01.2007 te Ortakut te vetem te Shoqerise Andon Kulla, eshte vendosur qe te behet nje shtese ne Objektin e aktivitetit te Shoqerise, duke shtuar edhe : Botim Gazete " Delvinjoti", gazete shoqerore-problematike-artistike-kulturore; trasport udhetaresh me autobus dhe bagazhet e tyre; agjenci trasport udhetaresh me autobus dhe bagazhet e tyre; sherbim dhe administrim te mbetjeve te ngurta urbane dhe inerte; sherbim dhe administrim te vorrezave publike dhe deshmoreve; sherbime varrimi publike dhe private; sherbim dekori .

[Signature]
[Signature]
[Signature]
[Signature]

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare " dhe te Ligjit 7667, date 28.01.1993 " Per Regjistrin tregetar "

KERKOJ

Depozitim in ne Regjistrin Tregetar te Vendimit Nr.1, date 13.01.2007 te Ortakut te vetem te Shoqerise, per shtese ne Objektin e Veprimtarise se Shoqerise " Kulla-A " sh.p.k..

Kerkuesi
Administratori i Shoqerise

Andon Kulla
[Signature]